VENDIM
Nr. 150, datë 30.9.2016

MBI KËRKESAT E KESH SHA DHE MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRISË PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 144, DATË 25.8.2016, TË BORDIT TË ERE-s, "PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP PËR SHITBLERJE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT APO PJESËRISHT NGA SHTETI/KESH SHA DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL/OSHEE SHA, PËR PERIUDHËN 1.7.2016–31.12.2016"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe nenit 16 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, në mbledhjen e tij të datës 30.9.2016, Bordi i ERE-s, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, në lidhje me kërkesat e KESH sh.a. dhe MEI për rishikimin e vendimit nr. 144, datë 25.8.2016, të Bordit të ERE-s, "Për miratimin e kontratës tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht apo pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për periudhën 1.7.2016–31.12.2016",

konstatoi se:

- Shoqëria KESH sh.a. ka marrë dijeni për vendimin e ERE-s nr. 144, datë 25.8.2016, nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 644 prot., datë 30.8.2016.

- MEI ka marrë dijeni për vendimin e ERE-s nr. 144 datë 25.8.2016 nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 642 prot., datë 30.8.2016.

- Shoqëria KESH sh.a. ka depozituar në ERE kërkesën nr. 7455/1 prot., datë 7.9.2016, protokolluar me tonën nr. 644/1, datë 8.9.2016, për rishikimin e vendimit nr. 144, datë 25.8.2016, të Bordit të ERE-s.

- Pika 5, e nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe nenit 16 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016", parashikon se: "Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.".

- Kërkesat e KESH sh.a. dhe MEI-t për rishikimin e vendimit nr. 144 datë 25.8.2016, janë depozituar jashtë afatit të parashikuar më sipër.

- Nga KESH-i dhe MEI nuk janë paraqitur prova të reja, të cilat të çojnë Bordin në marrjen e një vendim të ndryshëm nga ai nr. 144, datë 25.8.2016.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e KESH sh.a., për rishikim e vendimit nr. 144, datë 25.8.2016, të Bordit të ERE-s, "Për miratimin e kontratës tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht apo pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a. për periudhën 1.7.2016–31.12.2016", të paraqitur jashtë afatit të përcaktuar në ligj.

2. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e MEI-t për rishikim e vendimit nr. 144, datë 25.8.2016, të Bordit të ERE-s, "Për miratimin e kontratës tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht apo pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për periudhën 1.7.2016–

31.12.2016", të paraqitur jashtë afatit të përcaktuar në ligj.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë KESH sh.a., Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti